



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr.1840/6 Prot

Tiranë, më 28.12.2022

VENDIM

Nr.68, datë 28.12.2022

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, znj. (në vijim “ankuesja”) ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesat nr. 1839 Prot., dhe nr. 1840 Prot., datë 26.10.2022, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik/Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (në vijim “Autoriteti Publik”).

Në përputhje me shkronjën “ç” të nenit 65 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, duke qenë se ankesat lidhen me të njëjtat fakte, bazë ligjore dhe i drejtohen të njëjtit Autoritet Publik, Komisioneri çmon trajtimin e tyre në një vendim të vetëm.

Ankuesja, nëpërmjet kërkesës për informacion datë 04.10.2022, depozituar në adresën elektronike nexhila.kodra@shendetesia.gov.al, ka kërkuar t’i vendosen në dispozicion relacionet përfundimtare të Vendimeve të Këshillit të Ministrave të miratuara gjatë katër – mujorit të parë të vitit 2022, me propozim të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si vijon:

1. Nr. 23, datë 13.1.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 135, datë 7.3.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror””;
2. Nr. 40, datë 19.1.2022 “Për një ndryshim në vendimin nr. 207, datë 10.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerë””;
3. Nr. 43, datë 19.1.2022 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Kulturës të pronës, me emërtimin “Teatri Kombëtar i Kukullave”, me numër pasurie 6/163, zona kadastrale 8380, Tiranë”;
4. Nr. 57, datë 26.1.2022 “Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Fuat Vjerdha”;
5. Nr. 58, datë 26.1.2022 “Për miratimin e protokollit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, për funksionimin e përbashkët të spitalit rajonal “Memorial” në Fier, gjatë fazës kalimtare”;
6. Nr. 76, datë 2.2.2022 “Për përbërjen dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komisionit Qendror të Statusit “Fëmijë në përkujdesje të Republikës” dhe sekretariatit të tij”;
7. Nr. 77, datë 2.2.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 722, datë 11.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre””;
8. Nr. 135, datë 2.3.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 688, datë 14.11.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Fondit Shqiptar i Zhvillimit, të objektit, me emërtim “Oborr i Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë””;
9. Nr. 136, datë 2.3.2022 “Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të fëmijës Arbas Hoxha”;
10. Nr. 159, datë 12.3.2022 “Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për zbutjen e efekteve të ndikuara nga lufta në Ukrainë”;
11. Nr. 192, datë 30.3.2022 “Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Edlira Haxhiymeri”;
12. Nr. 210, datë 6.4.2022 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë 2021-2030”;
13. Nr. 211, datë 6.4.2022 “Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash të marrëveshjes së grantit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe Fondit Global për të Luftuar SIDA-n, tuberkulozin dhe malarien, për programin “Përshkallëzimi dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së përgjigjes kombëtare ndaj HIV/SIDA-s dhe tuberkulozit, në grupet kryesore të popullatës”, miratuar me vendimin nr. 219, datë 12.3.2020, të Këshillit të Ministrave”
14. Nr. 227, datë 13.4.2022 “Për përcaktimin e kushteve specifike të licencimit, dokumenteve shoqëruese, procedurave të shqyrtimit, vlefshmërisë, procedurave

- të pezullimit dhe të shfuqizimit të licencës për prodhuesit dhe tregtuesit me shumicë të pajisjeve mjekësore në Republikën e Shqipërisë”;*
15. Nr. 228, datë 13.4.2022 “Për përcaktimin e procedurave, kriterëve dhe afateve për ndjekjen e programeve të formimit e të kualifikimit profesional, të afateve të vazhdimit të ushtrimit të profesionit dhe të anëtarësimit në Urdhrin e Punonjësve Socialë për individët që nuk kanë formimin e kualifikimin profesional minimal”;
 16. Nr. 229, datë 13.4.2022 “Për një ndryshim në vendimin nr. 61, datë 3.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e paketave të pajisjeve mjekësore të rimbursueshme”, të ndryshuar”;
 17. Nr. 230, datë 13.4.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr.489, datë 30.7.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe masën e mbulimit të çmimit të tyre””;
 18. Nr. 246, datë 20.4.2022 “Për miratimin e paketës së Programit Kombëtar për Kujdesin e Shikimit për Fëmijët”;
 19. Nr. 282, datë 29.4.2022 “Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Mark Marku”;

Ndërkohë, nëpërmjet kërkesës për informacion datë 10.10.2022, ka kërkuar t’i vendosen në dispozicion relacionet përfundimtare të Vendimeve të Këshillit të Ministrave të miratuara gjatë periudhës Maj – Shtator 2022, me propozim të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si vijon:

1. Nr. 331, datë 18.5.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 24, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe mënyrës së funksionimit e organizimit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”, të ndryshuar”;
2. Nr. 404, datë 9.6.2022 “Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Arben Hysko”;
3. Nr. 436, datë 22.6.2022 “Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe të kriterëve të ofrimit të shërbimeve për një jetesë të pavarur për personat me aftësi të kufizuara”;
4. Nr. 437, datë 22.6.2022 “Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin për reagimin ndaj emergjencës COVID-19 në Shqipëri, ratifikuar me ligjin nr. 144/2020”;
5. Nr. 470, datë 6.7.2022 “Për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe kriterëve të ofrimit të shërbimeve të vendimmarrjes së mbështetur për personat me aftësi të kufizuara”;
6. Nr. 471, datë 6.7.2022 “Për një ndryshim në vendimin nr. 636, datë 26.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e llojeve, të mënyrës së shkëmbimit e të përpunimit të informacionit dhe të të dhënave statistikore, të kërkuara nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor””
7. Nr. 479, datë 13.7.2022 “Për përcaktimin e rregullave të publicitetit të pajisjeve mjekësore që tregtohen në Republikën e Shqipërisë”;

8. Nr. 554, datë 29.7.22 “Për organizimin e veprimtarisë së dhurimit vullnetar të gjakut nga punonjësit/nëpunësit e administratës shtetërore”;
9. Nr. 555, datë 29.7.2022 “Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së grantit, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe Fondit Global për të luftuar SIDA-n, Tuberkulozin dhe Malarien, për programin “Përshkallëzimi dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së përgjigjes kombëtare ndaj HIV/SIDA-s dhe Tuberkulozit në grupet kryesore të populates” miratuar me vendimin nr.219, datë 12.3.2020, të Këshillit të Ministrave”;
10. Nr. 571, datë 25.8.2022 “Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Eglja Lleshaj”;
11. Nr. 615, datë 22.9.2022 “Për një ndryshim në vendimin nr. 43, datë 19.1.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2022””;
12. Nr. 616, datë 22.9.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 404, datë 20.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së kriterëve e të procedurave të përfitimit të kompensimi financiar, nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse””;
13. Nr. 617, datë 22.9.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, të ndryshuar”.

Autoriteti Publik, lidhur me kërkesën e parë për informacion, nuk ka kthyer përgjigje. Ndërkohë, lidhur me kërkesën e dytë, nëpërmjet e-mail-it datë 25.10.2022, ka kthyer përgjigje duke cituar ndër të tjera se: “...Në zbatim të ligjit nr.9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, (neni 13, nenin 15, nenet 23-26) përcaktohet se, projektaktet së bashku me relacionin shoqërues depozitohen në Këshillin e Ministrave për miratim.

Në zbatim të nenit 100, pika 2 të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, mbledhjet e Këshillit të Ministrave zhvillohen të mbyllura...”

Pas përgjigjes së Autoritetit Publik, lidhur me kërkesën e dytë për informacion, ankuesja pretendon se: “...Relacioni është një dokument zyrtar që shoqëron projekt VKM-në. Si i tillë, ai mban stemën e institucionit propozues dhe nënshkrimin e drejtuesit të tij. Mes të tjerash, në të përfshihen mendimet dhe vërejtjet institucionale të ministrive dhe institucioneve të interesuara, si edhe shpjegimet për marrjen ose jo parasysh të tyre. Ky dokument zyrtar nuk rezulton të jetë subjekt i ndonjë kufizimi të ndonjë ligji të posaçëm, përfshirë këtu edhe ligjin 9000/2003. Gjithashtu, dokumenti nuk rezulton t'i nënshtrohet asnjërit prej kufizimeve të ligjit për të drejtën e informimit.

Relacioni përmban mendime dhe vërejtje me karakter institucional dhe jo personal. Vënia në dispozicion e dokumentit zyrtar “relacion” nuk cenon në asnjë mënyrë konfidencialitetin e mbledhjes së Këshillit të Ministrave, pasi relacioni nuk pasqyron

vlerësimet, debatet apo raportimet e anëtarëve të shprehura gjatë mbledhjes. Ai pasqyron vetëm mendimet dhe vërejtjet institucionale/zyrtare, pjesë e procesit të “konsultimit” të projekt-VKM-së, përpara se të dërgohet dhe të jetë pjesë e diskutimeve në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

Rrjedhimisht, relacioni përfundimtar që shoqëron projekt VKM-në, si një dokument zyrtar, që nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi ligjor, përbën një informacion publik, i cili duhet vënë në dispozicion sipas kërkesës për informim në ushtrim të një të drejte kushtetuese. Refuzimi për vënien në dispozicion të këtij informacioni është një akt i paligjshëm, i cili shkel të drejtën kushtetuese për informim të çdo qytetari”.

Në vijim, ankuesja kërkon nga Zyra e Komisionerit, ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit/dokumentacionit të cituar si më sipër.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesave, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në to, vlerësoi se ankesat përmbushin kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjëndje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Zyra e Komisionerit, me shkresat nr. 1839/1 prot., dhe nr. 1840/1 Prot., datë 02.11.2022 kërkoj nga Autoriteti Publik qëndrimin në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesja, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Në vijim, Autoriteti Publik, me shkresën nr. I – 14/2 Prot., datë 09.11.2022, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1840/2 Prot., datë 15.11.2022, ka kthyer përgjigje duke refuzuar vendosjen në dispozicion të informacionit të kërkuar me argumentin se: “*...Aktet nënligjore, të llojit Vendime të Këshillit të Ministrave, diskutohen dhe miratohen në mbledhjet e Këshillit të Ministrave. Këto mbledhje sipas Kushtetutës së vendit tonë zhvillohen me dyer të mbyllura.*

Relacionet e projekt vendimeve të Këshillit të Ministrave janë dokumente shoqëruese të këtyre projektvendimeve dhe i shoqërojnë për miratim në mbledhjet e Këshillit të Ministrave si një kërkesë e ligjit nr. 9000/2003, datë 30.01.2003.

Pasi projektvendimet diskutohen dhe miratohen në mbledhje të Këshillit të Ministrave, ato dërgohen për publikim në Fletore Zyrtare. Në Fletore Zyrtare publikohen të gjitha aktet e botueshme dhe arsyeja e publikimit është që ato të fitojnë fuqi juridike dhe në këtë mënyrë të fillojë zbatimin i tyre sipas ligjit nr. 9000/2003, datë 30.01.2003.

Sqarojmë faktin se të gjitha vendimet e Këshillit të Ministrave të paraqitura në kërkesat për informacion, janë akte të publikueshme dhe gjenden të botuara në Fletore Zyrtare.

Relacionet shpjeguese të tyre nuk janë të publikuara dhe në nenin 29, pika 2 të ligjit nr.9000, datë 30.01.2003, përcaktohet se ato që publikohen janë Vendimet e Këshillit të Ministrave, konkretisht: “Neni 29, pika : “2. Vendimet e Këshillit të Ministrave marrin fuqi juridike pas botimit në Fletoren Zyrtare. Për vendimet me karakter normativ mund të caktohet si datë hyrjeje në fuqi një datë tjetër nga ajo e botimit në Fletoren Zyrtare, ndërsa vendimet me karakter individual hyjnë në fuqi menjëherë, por botohen në Fletoren Zyrtare.”

Sqarojmë se në momentin që Vendimet e Këshillit të Ministrave, publikohen, ato marrin fuqi juridike dhe vetëm pas këtij momenti nisin të zbatohen. Me zbatimin e tyre arrihet qëllimi i aktit nënligjor që është të rregullojë një fushë të caktuar që synon vetë akti.

Për këtë arsye, konsiderojmë që informacioni publik dhe e dhëna e rregjistruar gjatë ushtrimit të funksionit publik janë vetëm aktet nënligjore, Vendimet e Këshillit të Ministrave të publikuara, në kuptim të nenit 2 pika 2 të LDI.

Në dallim nga vendimet që miraton Këshilli i Ministrave të cilat publikohen në QBZ, relacionet shpjeguese të Vendimeve janë vetëm dokumente shoqëruese që u shërbejnë diskutimeve në mbledhjet e mbyllura të Këshillit të Ministrave, por nuk përbëjnë dokumentin bazë që miratohet dhe as që publikohet , pasi ai nuk prodhon fuqi juridike dhe nuk ka asnjë efekt për t’u zbatuar. Dokumenti që prodhon fuqi juridike përkundrejt subjektet që drejtohet është vetëm Vendimi i Këshillit të Ministrave.”

Në këto kushte, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin citohet se: “Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... Kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”, si edhe bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me shkresën nr. 1840/5 Prot., datë 02.12.2022, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore. Seancë e cila u zhvillua me datë 07.12.2022, me prezencën e përfaqësuesve të Autoritetit Publik, të cilët rikonfirmuan qëndrimin e mbajtur me shkresën nr. I – 14/2 Prot., datë 09.11.2022, si dhe në mungesë të ankueses, e cila me e-mail-in datë 07.12.2022, bëri me dije mbi pamundësinë për pjesëmarrje fizike të saj.

Ankuesja ndërkohë, sipas kërkesës së Zyrës së Komisionerit, vendosi në dispozicion parashtrimet me shkrim mbi të cilat i qëndron ankesës dhe mbështet vijimin e ankimit.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri konstaton se argumentet e dhëna nga Autoriteti Publik për mos vënien në dispozicion të dokumentacionit nuk qëndrojnë.

Në nenin 2, të LDI parashikohet se: “Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njëjësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”.

Në kuptim të këtij parashikimi, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.”*

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar konstatohet se, informacioni i kërkuar, objekt i ankesave, është prodhuar si detyrim i ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 *“Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”*, i cili rregullon organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave, të Kryeministrit, të Zëvendëskryeministrit, të ministrit, të institucioneve në varësi të tyre, të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, marrëdhëniet ndërmjet tyre, si dhe aktet nënligjore, që nxjerrin këto organe.

Gjithashtu, në vendimin nr. 584, datë 28.8.2003 *“Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”*, i ndryshuar, i cili: *“ka si qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave lidhur me: a) përgatitjen dhe paraqitjen e projektakteve, si dhe shqyrtimin e tyre në Këshillin e Ministrave; b) organizimin e mbledhjeve të Këshillit të Ministrave...”*.

Ndërkohë, konstatohet gjithashtu se, Autoriteti Publik, megjithëse pranon zotërimin e dokumentacionit objekt i ankesave, pretendon se nuk mund t’a vendosë atë në dispozicion me argumentin se: *“...Relacionet shpjeguese të VKM-ve nuk janë të publikuara dhe në nenin 29, pika 2 të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003, përcaktohet se ato që publikohen janë vetëm VKM-të, konkretisht: “Neni 29, pika : “2. Vendimet e Këshillit të Ministrave marrin fuqi juridike pas botimit në Fletoren Zyrtare. Për vendimet me karakter normativ mund të caktohet si datë hyrjeje në fuqi një datë tjetër nga ajo e botimit në Fletoren Zyrtare, ndërsa vendimet me karakter individual hyjnë në fuqi menjëherë, por botohen në Fletoren Zyrtare.”*

Nga analizimi i kësaj pike të dispozitës rezulton qartë se Autoriteti Publik ka bërë një interpretim të gabuar të saj pasi, ashtu si edhe citohet më sipër, kjo dispozitë rregullon publikimin e Vendimeve të Këshillit të Ministrave në Qendrën e Botimeve Zyrtare, në funksion kjo të hyrjes në fuqi të aktit por, nuk kufizon vënien në dispozicion të akteve të cilat prodhohen/përpilohen nga autoritetet publike në kuadër të detyrës së tyre funksionale.

LDI, edhe pse jo të shprehur në mënyrë literale, bën një kategorizim të informacionit të aksesueshëm nga publiku në dy kategori kryesore: *1) informacioni që bëhet publik pa kërkesë dhe 2) informacioni që vihet në dispozicion pas kërkesës së subjektit të interesuar.* Në kategorinë e parë, përfshihen ato kategori informacioni, të cilat publikohen dhe vendosen në dispozicion nga autoriteti publik, pa qenë i nevojshëm angazhimi i ndonjë subjekti (sipas pikës 1 të nenit 7 të LDI apo detyrim që mund të vi nga legjislacioni specifik), ndërsa rasti konkret objekt shqyrtimi, i përket kategorisë së dytë, pasi kemi të bëjmë me një kërkesë për informim të depozituar pranë Autoritetit Publik e cila duhet të trajtohet në përputhje me parashikimet e nenit 11 e vijues të LDI.

Në këto kushte, në Kreun VI “*Paraqitja e projektakteve për shqyrtim në Këshillin e Ministrave*”, të vendimit nr. 584, datë 28.8.2003 “Për miratimin e rregullore së Këshillit të Ministrave”, i ndryshuar, parashikohet se: 43. Në përfundim të procesit të hartimit dhe të bashkërendimit me mendimet e ministrave dhe të drejtuesve të institucioneve të interesuara, ministri propozues paraqet projektaktin për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave. 44. Projektakti, relacioni shpjegues, dokumentet e përcaktuara në pikën 45 të kësaj rregulloreje, në dy kopje origjinale, së bashku me shkresën përcjellëse i dërgohen Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, të paktën 10 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e Këshillit të Ministrave. 45. Propozimet e projekteve shoqërohen me: a) projektaktin e bashkërenduar me ministrinë përkatëse; b) relacionin shpjegues, i cili përveç të dhënave të parashikuara në pikat 19 dhe 20 të kreut të katërt të kësaj rregulloreje, duhet të përmbajë edhe shpjegime për arsyet e mosreflektimit të vërejtjeve ose sugjerimeve të bëra nga ministrinë e interesuara; c) mendimet e ministrave dhe të drejtuesve të institucioneve të interesuara. Në çdo rast mendimi i Ministrisë të Drejtësisë duhet të shoqërojë projektaktin; ç) tekstin e plotë të traktatit a marrëveshjeve ndërkombëtare, në gjuhë të huaj dhe në shqip, të vërtetuar zyrtarisht nga Ministria e Drejtësisë, kur projektakti ka këtë objekt.”

Rrjedhimisht, referuar dispozitës së sipërcituar, Komisioneri vlerëson se, këto akte, të cilat përpilohen/regjistrohen pranë Autoritetit Publik dhe janë pjesë detyruese që shoqërojnë projektaktin përkatës, përbëjnë informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2 të LDI, në të cilën parashikohet se, “*informacion publik*” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”. Në këto kushte Autoriteti Publik duhet të vlerësojë vendosjen në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI.

Megjithëse gjatë hetimit administrativ, Autoriteti Publik nuk provoi në asnjë moment se në cilën pikë të nenit 17 të LDI e mbështet qëndrimin e tij lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, pasi është ky nen, i cili parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të legjitimojnë një autoritet publik për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Theksojmë se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në pikën 3 të nenit 3 të LDI parashikohet se, “*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*”.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012

“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesave nr. 1839 Prot., dhe nr. 1840 Prot datë 26.10.2022 të znj.
, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesave për informacion datë 04.10.2022 dhe 10.10.2022, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, brenda datës 09.01.2023.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 28.12.2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi